

AKTI THEMELIMI

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“DOR ARTA HANDMADE” SHPK

Sot me datë 27/ 05/ 2024, Znj. Edlira KURTI, shtetase shqiptare, e datëlindjes 27.11.1992, lindur në Librazhd dhe banuese në Tiranë, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e kartës së identitetit me Numër Personal J26127021W, vendosi të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar dhe në përputhje me dispozitat vijuese.

NENI 1

Themelimi

Emri i shoqërisë është “DOR ARTA HANDMADE” SH.P.K.

Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejt të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brëndshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri “DOR ARTA HANDMADE” SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi si dhe në Statutin vijues.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të shoqërisë

Qëllimi i krijimit të kësaj shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme, të cilat do të përcaktohen në Statutin e saj. Veprimtaria e kësaj shoqërie do të jetë me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin “DOR ARTA HANDMADE” SHPK. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Përshkimi i Aktivitetit

Punishte artizanale. Aktivitete në fushën e krijimtarisë dhe artizanatit. Aktivitete të punimit të qilimave, i sixhadeve dhe i produkteve të tjera artizanale në tezgjah.

Aktivitete të promovimit të trashëgimisë kulturore dhe turizmit.

NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e shoqërisë ndodhet në: Rruga Nacionale, Lagjja Ura e Spatharit, Ndërtesë Private Nr 26, Spathar, Librazhd.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë dhe Ortakët

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100 (njëqind lekë), i ndarë në 1 kuota me vlerë nominale të një kuote prej 100 lekë.

Ortakët themelues të shoqërisë Tregtare “DOR ARTA HANDMADE” SH.P.K zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Znj. Edlira KURTI zotëruese e 100 % (njëqind përqind) të kapitalit (kuotave) të shoqërisë;

Kapitali themeltar është shlyer plotësisht në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributeve të tyre në kapitalin themeltar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, date 14/04/2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi me i lartë vendimarrës;

Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 8

Administratori

Shoqëria administratohet nga Administratori i cili zgjidhet për një mandat pesë vjecar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqërisë do të jetë Znj. Edlira KURTI. Shoqëria përfaqësohet para cdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.



NENI 9

Të tjera

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë cdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statuti.

NENI 10

Ruajtja e sekretit

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata Kompetente.

NENI 12

Nënshkrimi

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortakët Themelues u gjet sipas vullnetit të tyre dhe u nënshkrua pa verejtje.

Ky Akt Themelimi hartohet në 4 kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKET THEMELUES

Znj. Edlira KURTI

Edlira Kurti

